

Informacion i shkurtër për popullatën

# Informacion për shëndetin tim. Në kohën e duhur, në vendin e duhur.



**DEP**  
Dosja elektronike  
e pacientit

- 1. Cfarë është dosja DEP?**
- 2. Dokumentet tuaja të aksesueshme në çdo moment**
- 3. Ndani dokumentet tuaja**
- 4. Sa e sigurt është DEP?**
- 5. Qëndroni të informuar**



# 1. Cfarë është dosja DEP?

Dosja elektronike e pacientit (DEP) është mbledhje personale e dokumenteve që lidhen me shëndetin tuaj.

Këtu përfshihen, për shembull, një radiografi, kartela juaj e vaksinave ose raporti i fletëdaljes nga spitali pas operacionit tuaj të fundit.

Specialistët e kujdesit shëndetësor i ruajnë këto dokumente tek DEP e juaja. Ju vetë mund të ruani gjithashtu dokumente si receta e syzeve, testamentet me gjallje të pacientit ose vlerat e presionit të gjakut në DEP-in tuaj.

Të gjitha këto informacione shëndetësore, të dhëna dhe dokumente ju përkasin ju – DEP ju përket ju.





## 2. Dokumentet tuaja të aksesueshme në çdo moment

Me DEP-in tuaj ju keni informacionet shëndetësore më të rëndësishme: në kompjuterin tuaj, në smartphone-nin tuaj – në shtëpi, rrugës apo jashtë kufirit.

Edhe nëse ju humbet Smartphone dokumentet mbeten. Pasi ato nuk janë të ruajtura në aparatin tuaj por tek ofruesi i DEP.

Ju nuk jeni të detyruar për të pasur një DEP. DEP është diçka vullnetare për ju.




### 3.

## Ndani dokumentet tuaja

Vetë ju vendosni, kush nga stafi mjekësor mund të shohë çfarë dokumentesh.

Me DEP ju vazhdimisht keni një pasqyrë të dokumenteve tuaja dhe mund ti dërgoni personelit mjekësor informacionet që mund t'i nevojiten për shëndetin tuaj,

Nuk dëshironi ta drejtoni vetë DEP-in tuaj? Ju mund t'ia delegoni këtë detyrë një personi të besuar. Ky person mund të jetë një mikeshë, një pjesëtar i familjes ose një përfaqësues i stafit mjekësor si për shembull mjeku juaj i familjes.



## 4.

# Sa e sigurt është DEP?

Kush i ruan dokumentet tuaja në DEP ose kush i sheh – gjithçka protokollohet automatikisht në DEP-in tuaj. Kështu ju në çdo moment e dini se çfarë ndodh me dokumentet tuaj në dosje.

Ligji federal mbi dosjen elektronike të pacientit parashikon, mënyrën e organizimit të DEP dhe sesi duhet të jetë e siguruar ajo teknikisht.

Çdo ofrues i DEP do të verifikohet, certifikohet dhe kontrollohet plotësisht. Në këtë mënyrë garantohe siguria e dokumenteve tuaja në DEP.

Ofruesit e certifikuar të DEP janë të pajisur me logon zyrtare të sigurisë:



# 5.

## Qëndroni të informuar

Informohuni vazhdimisht për të rejat më të fundit.  
Informacione të tjera gjeni në:

Gjermanisht [www.patientendossier.ch](http://www.patientendossier.ch)

Frëngjisht [www.dossierpatient.ch](http://www.dossierpatient.ch)

Italisht [www.cartellapaziente.ch](http://www.cartellapaziente.ch)

Anglisht [www.patientrecord.ch](http://www.patientrecord.ch)

**ehealthsuisse**

Kompetenz- und Koordinationsstelle  
von Bund und Kantonen

Centre de compétences et de coordination  
de la Confédération et des cantons

Centro di competenza e di coordinamento  
di Confederazione e Cantoni



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra



Konferenz der kantonalen Gesundheits-  
direktorinnen und -direktoren  
Conférence des directrices et directeurs  
cantonaux de la santé  
Conferenza delle direttrici e dei direttori  
cantionali della sanità